



**DITA NDËRKOMBËTARE
E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E LUTJES
KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE**

MIGRIM PA TRAFIKIM



Thuaji **PO** Lirisë dhe **JO** Skllavërisë



**Përgjigje e Bashkuar
Kundër Trafikimit**



URAT

Shën BAKHITA: 8 shkurt 2018
TRAFIKIMI DHE MIGRIMI

Thuaji **PO** Lirisë, thuaji **JO** Skllavërisë

MODERATORI: Hapja e liturgjisë

LEXUESI 1: *“Skllavëria e ditëve të sotme, lidhur me trafikimin e personave, punën e detyruar dhe prostitucionin, trafikimin e organeve, është një krim kundër njerëzimit”*

Ka dhjetëra miliona njerëz në botë që vuajnë nga trafikimi, dhe pjesa më e madhe e tyre janë gra. Trafikimi mbivendoset dhe bashkohet me imigrimin klandestin, me punësimin e punëtorëve të huaj në kushte të ngjashme me skllavërinë, me gratë e përfshira në tregtinë e seksit ose që janë bërë subjekt i martesave me leverdi. Jeta njerëzore është një objekt, i tregtuar dhe i shfrytëzuar për përfitim, për punë të detyruar ose poshtëruese në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, për shfrytëzim seksual dhe skllavëri në familje. Le t’i ndezim zemrat dhe jetët tona që të jemi një dritë mikpritëse shprese dhe kontakti.

Le të ndezim dy qirinj për t’i ngrohur zemrat dhe jetët tona që të takojmë dhe të mirëpresim vëllezërit dhe motrat tona në lëvizje, duke ndërtuar së bashku shpresën dhe lirinë nga çdo lloj skllavërie.

KËNGA HAPËSE: Merre jetën time

Merre jetën time, mere Ti o Zot,
e flaka jote djegtë në zemrën time.
Gjithë qenia ime dridhet për ty
je Zoti im o Hyjnori mbret

Ref: Burimi i jetës, paqes, dashurisë,
unë ty të thërras, natë edhe ditë.
Je mbështetja ime, më drejto pra Ti.
Më jep Ti jetën, o e mira ime.

Nga e keqja e pabesë, më ruaj o Zot.
Eja gëzimi im dhe Krijues i fesë.
Nëse nata e zezë, sytë e mi errëson,
bëhu ylli im, Eja më ndriço. Ref:

Ja mëngjesi i ditës së re,
dielli i bukur shkëlqen në qiell.
Krishti afrohet, vuajtje s' do ketë

FJALA HAPËSE: Arqipeshkëvi Mons. George Frendo OP.

LEXUESI 2: Trafikimi dhe migrimi

Tema e Ditës Botërore të Lutjes dhe Ndërgjegjësimit ndaj Trafikimit për vitin 2018 thekson tragjedinë njerëzore të trafikimit të personave që migrojnë: migrantët, refugjatët dhe të evokuarit. Neve na kërkohet t'i hapim sytë për këtë problem të kaq shumë grave dhe burrave, motrave dhe vëllezërve tanë. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi me migrantët janë dy realitete të dallueshme që janë gjithmonë të lidhura. Dhuna dhe shfrytëzimi që vuajnë migrantët, të cilët lëvizin pa vizë drejt vendit ku ata duan të shkojnë, shpesh interpretohet si trafikim i qenieve njerëzore.

MODERATORI: Le të lutemi së bashku

O Zot, streha jonë, ju që ndani udhëtimin me migrantët dhe refugjatët, duke ndriçuar hapat e tyre me shpresë. Ju, o Zot jeni shumë i afërt me zemërthyerit. Derdhni shpirtin tuaj mbi udhëheqësit e botës. Le t'i shohin ata tragjeditë e familjes sonë njerëzore, dhe të preken për t'u përgjigjur me mençuri, dhembshuri dhe guxim. Na i hap sytë dhe zemrat ndaj dinjitetit që Zoti iu ka falur të gjithë njerëzve tuaj. Na nxitni të mirëpresim fqinjët tanë, dhe të jemi dëshmitarë të dashurisë suaj. Nëpërmjet Krishtit Zotit tonë, Amen.

[\(Rachel McCarthy/CAFOD\)](#)

FILM I SHKURTËR tregohet për Migrimin e Sigurt (Film i MWL)

MODERATORI: Le t'i japim këtij realiteti një qendërzim të rëndësishëm në jetët dhe zemrat tona, duke e hapur veten për të mirëpritur, për të shpresuar dhe për t'u takuar. Le t'i japim dritë lirisë duke luftuar skllavërinë.

Le të vendosim një rrip te kyçi i dorës dhe të mos harrojmë kurrë të luftojmë përditë kundër trafikimit të qenieve njerëzore. (Ripi i kyçit të dorës me sloganin “Të ndalojmë trafikimin e qenieve njerëzore – ndiqni rrugën e migrimit të sigurt”, iu është dorëzuar të gjithë pjesëmarrësve në Shërbimin e Lutjes)

Do të luhet muzikë gjatë gjithë kësaj kohe.

LEXUESI 3: Leximi i Ungjillit Luka – Lk 10:25-37 Alegoria e Samaritanit të Mirë. Kush është fqinji im?

Dhe vini re, një doktor i ligjit u ngrit për ta vënë në provë dhe i tha: “Mësues, çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetën e përjetshme?” Dhe ai i tha: “Çfarë është shkruar në ligj? Si e lexon?” Ai duke u përgjigjur tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënde, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde dhe me gjithë mendjen tënde, edhe të afërmin tënd porsivetveten.” Jezusi tha: U përgjigje drejt; vepro kështu dhe do të rrosh.” [...] Por një samaritan, që po udhëtonte, i kaloi afër, e pa dhe kishte dhembshuri. Dhe mbasi iu afrua, ia lidhi plagët duke ia larë me vaj dhe me verë; pastaj e vuri mbi kafshën e vet, dhe e çoi në një han dhe u kujdesua për të. Dhe të nesërmen, para se të niset, nxori dy denarë dhe ia dha hanxhiut duke i thënë: “Kujdesu për të dhe ç’të shpenzosh më shumë, do të të jap kur të kthehem” Cili nga këta tre, pra, të duket se që i afërmi i atij që ra në duart e kusarëve?” Dhe ai tha: “Ai që u tregua i mëshirshëm ndaj tij.” Atëherë Jezusi i tha: “Shko dhe bëj kështu edhe ti.”

KËNGA Numër 2: Eja ti o Zot

Eja ti o Zot na shpëto (3 herë)

O Zot na shpëto

Eja ti o Zot na çliro (3 herë)

O Zot na çliro

Eja ti o Zot na ngushëllo (3 herë)

O Zot na ngushëllo

Eja ti o Zot mos vono (3 herë)

O Zot mos vono

LEXUESI 4: Dëshmia e një vajze të trafikuar, që la vendin e saj për një të ardhme më të mirë dhe tashmë është shfrytëzuar në Itali, në rrugë.

"Ato vijnë një herë në javë, dhe më kanë ndaluar tashmë tre herë. Ato duken dy vajza shumë të mira. Ato përpiqen shumë të më shpjegojnë të gjitha mënyrat se si mund të më ndihmojnë. Mjekun, punën dhe faktin se në Itali ka qaq shumë mundësi për një vajzë si unë. Ato mendojnë se unë jam qaq naive sa që t'iu besoj atyre. Ashtu si edhe premtimet e xhaxhit tim nuk kishin qenë të mjaftueshme, kur ai më propozoi që të largohesha nga Rumania me Konstantinin, dhe në vend të saj më dhunoi. Ose premtimet e Konstantinit për të më gjetur një punë në Itali, por që më pas më shiti tek Adriani për disa euro. Jo, unë nuk jam qaq naive; nëse jam me fat ata do të jenë policë dhe do të më kthejnë në shtëpi, ndërsa nëse jam pafat do të punoj si prostitutë kushedi se ku. Të paktën, tashmë Adriani më lejon t'i dërgoj para nënës sime në Rumani. Ajo ende beson se gjithçka ka shkuar mirë. Është e qartë se unë sot e urrej këtë punë aq shumë sa edhe në ditën e parë. Mendoj se një ditë do të hipi në një makinë dhe nuk do të zbres kurrë sërish."

REFLEKTIM DHE QETËSI

Udhëheqësit na drejtojnë në meditim.

- Vendoseni veten në vendin e personave të kësaj dëshmie.
- Nëse do të isha në një situatë të ngjashme, çfarë do të bëja? Cili do të ishte reagimi im? A përfaqëson kjo dëshmi realitetin e vendit/qytetit tim?
- Kujt doni t'ia dedikoni lutjen tuaj?

BISEDË E SHKURTËR: Rovena Voda – Zëvendës Ministre e Punëve të Brendshme

MODERATORI: Le ta themi sërish këtë lutje së bashku:

O Zot, streha jonë, ju që ndani udhëtimin me migrantët dhe refugjatët, duke ndriçuar hapat e tyre me shpresë. Ju, o Zot jeni shumë i afërt me zemërthyerit. Derdhni shpirtin tuaj mbi udhëheqësit e botës. Le t'i shohin ata tragjeditë e familjes sonë njerëzore, dhe të preken për t'u përgjigjur me mençuri, dhembshuri dhe guxim. Na i hap sytë dhe zemrat ndaj dinjitetit që Zoti iu ka falur të gjithë njerëzve tuaj. Na nxitni të mirëpresim fqinjët tanë, dhe të jemi dëshmitarë të dashurisë suaj. Nëpërmjet Krishtit Zotit tonë, Amen. [\(Rachel McCarthy/CAFOD\)](#)

PARAQITJE ME SLIDE E FOTOGRAFIVE të migrimit dhe vuajtjes së shumë
Çdo të pranishmi i është dhënë një qiri. Secili qiri është i ndezur. Moderator
drejton reflektimin dhe simbolizmin pas qiririt që ndriçon ceremoninë.

Pas ndezjes së qirinjve, udhëheqësi paraqet punën e URAT-it, një dritë që ndriçon Shqipërinë.

LEXUESI 5: Le të lutemi së bashku:

Oh Zot, na ndihmo të luftojmë kundër të gjitha formave të skllavërisë. Së bashku me Shën Bakhita, ne kërkojmë t'i jepni fund trafikimit të qenieve njerëzore. Na jepni mençurinë dhe forcën për të qenë pranë atyre që janë lënduar në trupin, zemrën dhe shpirtin e tyre, që së bashku të mund të përmbushim premtimin e jetës dhe dashurisë së dhimbsur dhe të pakufishme që ju iu jepni vëllezërve dhe motrave tona të shfrytëzuara. Prekni zemrat e atyre që janë përgjegjës për këto krime të rënda, dhe mbështesni angazhimin tonë për lirinë, dhuratën tuaj për të gjitha bijat dhe djemtë tuaj. Amen.

BEKIMI MBYLLËS: Arqipeshkëvi George Frendo OP.

Mbyllja dhe kënga e fundit: Shpejto o Zot

Shpejto o Zot e na shpëto (2 herë)

Shpejto o Zot mëshirë

Eja ti e na shpëto

Shpejto o Zot e na çliro (2 herë)

Shpejto o Zot mëshirë

Eja ti e na çliro

Shpejto o Zot e na ngushëllo (2 herë)

Shpejto o Zot mëshirë

Eja ti e na ngushëllo

Shpejto o Zot e mos vono (2 herë)

Shpejto o Zot mëshirë

Eja ti e mos vono

MIGRIM PA TRAFIKIM

*Thuaji **PO** Lirisë dhe **JO** Skllavërisë*

Email: urat.net@gmail.com

Facebook: URATnetwork

